



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr 24 Datë 10.05.2007

PËR MIRATIM FONDI PREJ 700.000 LEKË PER EKIPI E
FUTBOLLIT "SKENDERBEU"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, me propozim të Komisionit të Kulturës dhe Sporteve, bazuar në 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32. pika "dh", pika "m". Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr 2 dt 02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Te miratojë për ekipin e futbollit "Skënderbeu" fondin prej 700 000 lekë për kualifikim në ligën superiore të detajuar si më poshtë :
25 sportistë x 25.000 lekë = 625.000 lekë
2 trajnerë x 30.000 lekë = 60.000 lekë
1 mjek x 15.000 lekë = 15.000 lekë
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezerve i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet 00. 04980. 05 Art 6091100 - 700.000 lekë

Shtohet 00. 08140 05 Art 6020000 + 700.000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës. Sektori i Sportit dhe klubi i futbollit "Skënderbeu"
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit

Raimonda NASE